REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE
Pranuar më / Primljeno 06.04.2023
Nr. / Br. | Shtojcë - Prilog
10-334/07-0025046/23
PODUJEVË - PODUJEVO

**Republika e Kosovës /** Komuna e Podujevës

**Republika Kosova /** Opština Podujevo

**Republic of Kosova** Municipality of Podujeva

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM**

# NJOFTIM

Në mbështetje të ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor, udhëzimit administrativ nr. 07/2015 për licencimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus, rregullorës komunale për transportin rrugor në territorin e komunës së Podujevës nr. 01-345/01-0008883/23 të datës 31 Janar 2023, vendimit për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano – periferike në vendbanimet rurale dhe orarin e qarkullimit nr. 01-345/01-0008885/23 të datës 31 Janar 2023, nenit 19 pika (1.14) dhe (1.6) të Statutit të Komunës së Podujevës, i miratuar me dt. 29 qeshor 2018.
Lajmërohen të gjithë operatorët të cilët ushtrojnë veprimatrinë e transportit të udhëtarëve në transportin urban, dhe urbano- periferik në vendbanimet rurale, të pajisen me licenca të punës.

Afati i aplikimit është deri me datën 28.04.2023.

Dokumentacioni për aplikim merret dhe dorëzohet në zyrën për shërbime me qytetarë.

Ndaj operatorëve të cilët nuk pajisen me licenca do të merren masa ndëshkuese dhe parandaluese për ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

Podujevë
06.04.2023

Drejtori
Bahri Selimi

KOMUNA E PODUJEVËS - OPSTINA PODUJEVO
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
PODUJEVË / O

## Kushtet që duhet të plotësohen për licencimin e operatorëve:

1. Aplikacionin,
2. Çërtifikatën për regjistrimin e biznesit në Kosovë,
3. Selia e kompanisë të jetë në territorin e Komunës së Podujevës,
4. Të ketë reputacion të mirë,
5. Të posedojë dëshminë e lëshuar nga gjykata kompetente se menaxheri i operatorit nuk ka pengesa ligjore të zhvillojë veprimtarinë në lëminë e transportit,
6. Të posedojë dëshminë e lëshuar nga ATK që operatori nuk ka pengesa të natyrës administrative fiskale,
7. Të ketë kapacitete të qëndrueshme financiare të cilën e vërteton në bazë të pronësisë mbi mjetet apo garancionit financiar / bankar,
8. Të ketë menaxher transporti me kompetencën e nevojshme profesionale,
9. Të ketë në pronësi së paku 1 autobus apo minibus,
10. Të ketë automjetet e transportit në gjendje të mirë teknike – eksploatuese.

## Kushtet që duhet të plotësohen për tu pajisur me çertifikatë të mjetit transportues:

1. Kopjen e çertfikatës së regjistrimit të automjetit transportues (librezën),
2. Kopja e polisës së sigurimit,
3. Kopja e vërtetimit për aparatin zjarrfikës,
4. Kopja e vërtetimit të tahografit,
5. Çertifikata që mjeti është teknikisht në rregull,
6. Në mjet të jetë i shkruar në të dy anët mbishkrimi i emrit të firmës.